



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

KUVENDI I KOMUNËS PEJË

I.Numër: 016-01/19056, datë: 31 Mars 2026

Në bazë të nenit 11, nenit 12. paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), dhe nenit 24. të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/L – 049 për Financat e Pushtetit Lokal, Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me ligjin Nr. 05/L-007, neni 8, paragrafi 6 dhe 7 i Ligjit Nr. 10/L-001 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026 dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4. të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431, dt. 30 Shtator 2020, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 31 Mars 2026, në propozim të Drejtorisë për Buxhet e Financa dhe kryetarit të Komunës, merr:

**VENDIM
Nr. 21/2026**

Mbi tejkalimin e planit të hyrave vetanake për vitin 2025 dhe bartjen në vitin 2026

- MIRATOHET** tejkalimi i planit buxhetor i të hyrave vetanake për vitin 2025, në shumë prej: 2,202,470.40 € dhe shpërndarjen e tyre në dy nën programe buxhetore, në kategorinë mallrave dhe shërbime dhe shpenzimeve kapitale, të vitit 2026, si vijon:
 - **Mallra dhe shërbime ne shume 233,388.€**
 - **Investime kapitale ne shume 1,969,082.40 €**

1.1. Në kategorinë mallra dhe shërbime:

Administrata (16319) shuma prej 30,000. €
Planifikimi Urban dhe Mjedisi (66100) shuma prej 15,000.€
Kultura, rinia dhe sportet (85019) shuma prej 100,000.€
Arsimi Parafillor (92570) shuma prej 88,388.€

1.2. Në kategorinë e shpenzimeve kapitale, ne nën programet

Administrata (16319) ne projektet:

“Ndërtimim i objektit të Administrates në hapësirat e ish Urbanizmit (Arsim, Urbanizëm, Shërbime Publike, Kultur)” kodit 55800 ne shumë prej 290,000.€

Infrastruktura Rrugore (18019) ne projektet:

” Ndërtimi i impiantit në Jabllanicë të Leshanit” kodit 54664 ne shumë prej 400,000.€

“Ndërtimi i sheshit prej Ures së Zallit deri te Ura e re (Hajdaraget)” kodit 55905 ne shumë prej 200,000.€

“Ndërtimi i kanalit në lagjen Asllan Çeshme” kodit 54662 ne shumë prej 95,000.€



“Ndertimi i mureve mbrojtse nga rreshqitja e dheut ne lagjen Kapeshnic dhe Dardani “projekt i ri ne shumë prej 114,300.42€

“Rregullimi i kanalizimit ne lagjet Vitomeric, Kristal, Qyshk, Daradani, Raushiq “ projekt i ri ne shumë prej 100,000.€

“Ndriçimi në Vitomericë, fshatrat e Podgurit, Lugut të Trestenikut, Lugut të Leshanit, Lugut të Baranit dhe lagjet e qytetit“ projektet i ri ne shumë prej 100,000.€

“Blerja e autofshisave me furqa rrotuelluse per fshirjen e rrugëve në qytet” projekt i ri në shumë prej 160,000. €

Nen programi Bujqësi (47019)

“ Ndërtimi kanaleve të ujitjes në regjionin e lugut të Baranit,Trestenikut, Leshanit, Podgurit dhe Fusha e Pejes” kod i projektit 54572 në shumë prej 84,781.98.€

Nen programi Shërbimet e shëndetësisë primare (74100) në projektet:

“Furnizim me paisje dhe inventar per funksionalizimin e QMF ne fsh. Trestenik” projekt i ri në shumë prej 40,000.€

Shërbimet Rezidenciale (75592) në projektet:

“ Blerja e inventarit për shtëpinë e qendrimit të përkohshëm” projekt i ri në shumë prej 40,000.€

Nen programi Shërbimet Kulturore (85019) ne projektin:

“ Ndertimi i fushes se peste e tenisit ne fsh. Brestovik” projekt i ri ne shumë prej 100,000.€

Arsim dhe Shkencë

Arsimi fillor, i mesëm i ulët (93540) ne projektet:

“Blerja e kombibusëve për shkolla “ kod i projektit 56145 ne shumë prej 135,000.€

“Ndërtimi i shkollës fillore në fshatin Llozhan” kod i projektit 20776 ne shumë prej 150,000. €

Arsyetim:

Tejkalimi i realizimit i te hyrave mbi plan kërkohet te buxhetohet për mbulimin e mungesave te obligimeve te pa paguar te vitit paraprak, mjete qe mbesin te pa angazhuar shfrytëzohen për realizimin e projekteve te reja te arsyeshme dhe me prioritet.

2. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorin për Buxhet e Financa të Komunës së Pejës.

3. Ky vendim shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në Web-faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi ti dërgohet:

MAPL, MFPT,

Kryetarit të Komunës,

DBF – së, Arkivë.

